

Njoftim

Sot, më datë **21.04.2023, ora 17:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Edlira Petri (Relatore);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Esmeraalda Xhili (Anëtare);**
- 4. Emona Muçi (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluarnë ambientet e godinës “Poli i Drejtësisë”, salla e konferencave të KLGJ-së, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.14 Regj.Themeltar, Datë 20.04.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”, përfaqësuar nga Altin Kaziaj.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - (KQZ).

Person i interesuar: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Indrit Sefa.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr.62, datë 19.04.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

Ndryshimin e vendimeve nr. 360 dhe 363 të KSH, datë 15.04.2023, duke ndryshuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie, Bashkia Tiranë, si dhe për 60 bashkitë e tjera në vend, duke vendosur heqjen e Logos së Partive dhe/ose të Koalicioneve, nga përmbajtja e fletës së votimit për Kandidatët për Kryetar Bashkie.

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ; Nenet 4, pika 1, Nenet 9, Neni 45, Neni 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, 139, 145 e vijues i Kodit Zgjedhor të RSH.

me Vendimin Nr.14, datë 21.04.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimitisht,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e padisë.

2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
4. U shpall në Tiranë më datë 21.04.2023.

Tiranë, më 21.04.2023.

Gjykata Administrative e Apelit